



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.980/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “ILLYRIA” SH.A, me NUI: 810483769, me seli në rr. “Nënë Tereza”, nr. 33, në Prishtinë, kundër debitorit Kevork Arek Findikliyan B.I, me seli në rr. “Shaip Pacolli” nr. 4, në Prishtinë, të cilin e përfaqëson D.S, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.364/21 të datës 07.07.2021 të Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 26.05.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Kevork Arek Findikliyan B.I, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.364/21 i datës 07.07.2021, i Përmbartuesit Privat Ilir Mulhaxha dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimeve “ILLYRIA” SH.A, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.364/21 të datës 07.07.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës: nr.81614/19 të datës 18.10.2019; Faturës: nr.92002/19 të datës 19.10.2019; Faturës: nr.10546/19 të datës 17.12.2019; Faturës: nr.477/20 të datës 18.01.2020; me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të caktohet përmbartimi në shumën prej 344.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditëve, me ndalimin e mjeteve nga bankat afariste në Kosovë, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, përmbartuesi privat, të bëjë sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, duke theksuar se faturat e cekura në

propozim nuk mund të konsiderohen si dokumente të besueshme apo autentike, andaj urdhri përmbartimor në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë. Më tutje ka shtuar se raporti juridik në mes të debitorit dhe kreditorit është ndërprerë dhe faturat të cila i ka dërguar kreditori, janë kundërshtuar nga debitori ashtu siç edhe mund të provohet në njoftimin për ndërprerje të policës së sigurimit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbartimor P.nr.364/21 i datës 07.07.2021 i përmbartuesit privat Ilir Mulhaxha si dhe të obligohet kreditori që t'i paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje për prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura nr. 81614/19 e datës 18.10.2019; Fatura nr. 92002/19 e datës 19.10.2019; Fatura nr.10546/19 e datës 17.12.2019 dhe Fatura nr.477/20 të datës 18.01.2020; në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se faturat në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbaram nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se këto fatura në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjtat nuk përmbajnë as nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt, si të tilla të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbaram, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi privat ka lejuar përmbaramin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaramore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 980/22, datë 26.05.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,

në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.